

LIGJI NR. 04/L-137

PËR MBROJTJEN E BURIMEVE TË GAZETARISË

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MBROJTJEN E BURIMEVE TË GAZETARISË

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj rregullon çështjen e mbrojtjes së të drejtës së gazetarëve për të ruajtur burimin e informacionit, duke u bazuar në nenin 40 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky ligj është i zbatueshëm për të gjithë gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias, që janë të angazhuar në mbledhjen, përgatitjen, dhe përhapjen e informacionit nëpërmjet medias, të cilët janë nën juridiksionin e Republikës së Kosovës e që nuk mund t'iu mohohet e mbrojtja e të drejtave dhe privilegjeve të garantuara nga ky ligj, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë çështje të ndryshme të lirisë së medias.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Gazetaria** – mbledhja, përgatitja, përzgjedhja, fotografimi, regjistrimi, shkrimi, redaktimi, raportimi apo publikimi i lajmit dhe informacionit që ka të bëjë me ngjarje vendore apo ndërkombëtare, të cilat janë me interes për t'i përhapur në publik nëpërmjet medias.

1.2. **Gazetar** - çdo person fizik apo juridik, i cili është i angazhuar rregullisht ose profesionalisht direkt për mbledhjen, redaktimin, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit për publikun, nëpërmjet një mediumi.

1.3. **Media** - të gjitha format e komunikimit që kanë për qëllim shpërndarjen e informacionit te një numër më i madh i popullatës, duke përfshirë, mes tjerash, mediat e shtypura (përfshirë edhe broshurat, afishet, fletëpalosjet, revistat dhe gazetatat), filmin/video xhirimet, radiotransmetimet dhe transmetimet televizive, audio incizimet dhe riprodhimet, transmetimet e shërbimit me mesazhe.

1.4. **Profesionistët e medias** - stafi editorial dhe çdokënd, i cili gjatë ushtrimit të funksionit, mund të jetë në pozitë që të ketë njohuri për informacionin që mund të çojë tek zbulimi i burimit, pavarësisht nëse ky bëhet përmes mbledhjes, trajtimit editorial, prodhimit apo shpërndarjes së informacionit. Termi përfshin gjithashtu kameramanët, fotografët dhe stafin e tyre mbështetës sic janë shoferët, përkthyesit etj.

1.5. **I angazhuar profesionalisht** - të qenurit i punësuar nga një agjensi lajmesh apo kompani mediatike, ose i vetëpunësuar dhe puna e bërë është a) mjaftueshëm e lidhur apo e krahasueshme me punën e mediave tradicionale; b) është bërë me qëllimin për mbledhjen, redaktimin, prodhimin dhe shpërndarjen e lajmit; c) materiali ose informacioni është siguruar përgjatë aktivitetit të mbledhjes së lajmit.

1.6. **Burim** – çdo person, që i jep informacion gazetarit.

1.7. **Materiale** - shkrime, dokumente, blloqet e shënimeve, kasete të zërit apo filmike, regjistrime, video, fotografi, ose mjete të tjera të papublikuara, të mbledhura me qëllimin për të ofruar nëpërmjet medias informacion për publikun.

1.8. **E drejta e heshtjes** – ky term në këtë ligj nënkupton të drejtën për të mbrojtur identitetin e burimeve të informacionit përpara gjykatës, gjatë procedurës penale.

Neni 4

1. Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias kanë të drejtën e heshtjes rreth burimeve të tyre të informacionit. Me përjashtim të rasteve të referuara në nenin 5 të këtij ligji, gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias nuk mund të detyrohen të zbulojnë burimet e informacionit ose të japin materiale, që ndër të tjera:

1.1. mund të zbulojnë identitetin e burimeve të tyre të informacionit;

1.2. mund të zbulojnë natyrën apo origjinën e informacionit të tyre;

1.3. mund të zbulojnë identitetin e një autori të një teksti ose të një produkti audio-vizual;

1.4. mund të zbulojnë përmbajtjen e informacioneve dhe vetë dokumenteve, nëse kjo gjë mund të çojë tek identifikimi i burimit;

Neni 5

1. Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias janë të detyruar të zbulojnë identitetin e burimit të informacionit siç referohet në nenin 4 të këtij ligji, vetëm me kërkesë të gjykatës kompetente dhe vetëm nëse: zbulimi i identitetit të burimit të informacionit është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim serioz të integritetit fizik me pasojë vdekjen të një ose më shumë personave;

2. Një kërkesë e tillë është legjitime vetëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

2.1. informacioni i kërkuar është me rëndësi shumë të madhe për të parandaluar këto krime; si dhe

2.2. informacioni i kërkuar nuk mund të sigurohet në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 6

1. Çdo masë e zbulimit apo investigimit që synon të identifikojë burimin e informacionit përfshirë kontrollet fizike ose jofizike, si më poshtë është e ndaluar: kontrolli në shtëpi, ndërtesa të kompanive mediatike, ose çdo kompani të komunikimit online me publikun, të agjensive të lajmeve, në automjetet e këtyre kompanive apo agjensive, ose shtëpitë e gazetarëve.

2. Masat e zbulimit dhe masat investiguese do të zbatohen tek të dhënat që lidhen me burime të informacionit të gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias, vetëm nëse të dhënat mund të parandalojnë krime të referuara në nenin 5 të këtij ligji dhe që janë subjekt i kushteve të përcaktuara me këtë nen.

3. Kur hetimet e lartpërmendura janë të lidhura me aktivitetin profesional, ato mund të lejohen vetëm nga gjykata kompetente. Hetimet duhet të shoqërohen nga një vendim i shkruar dhe i arsyetuar, i cili duhet të tregojë natyrën e shkëljes në bazë të së cilës lejohet kontrolli në shtëpi apo dhomë të lajmeve si dhe objekti dhe arsyeja që justifikon kontrollin e shtëpisë apo dhomës së lajmeve.

Neni 7

1. Me qëllim të mosrrezikimit të sigurisë së tyre, gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias, nuk mund të detyrohen me anë të ligjit që të japin informacion ose materiale, të cilat janë mbledhur në

kontekstin e mbulimit të një gjendjeje të jashtëzakonshme të shpallur sipas neneve 56 dhe 131 të Kushtetutës. Këto materiale nuk mund të përdoren në procedimet legale; ato deklarohen të pavlefshme.

2. Çfarëdo përjashtimi nga ky parim duhet të mbështetet në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 8

Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias nuk mund të ndiqen penalisht në rast se marrin ose përdorin dokumente të cilat janë siguruar në mënyrë të paligjshme nga palët e treta, kur janë duke ushtruar të drejtën e heshtjes për burimet e tyre të informacionit.

Neni 9

Në raste të nxjerrjes të sekretit profesional, të përcaktuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias nuk mund të ndiqen penalisht, nën akuzën e bashkëpunimit në krim, kur ata janë duke ushtruar të drejtën e heshtjes në lidhje me burimet e tyre.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 04/L-137
31 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-044-2013, datë 19.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga